



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 1136/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lart Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Burim Kelmendi, zyrtar ligjor i subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, dega në Istog, për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit për Rivotim për Kryetar të Komunës së Istogut të mbajtura më datë 17.12.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 19.12.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Burim Kelmendi, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Istog, me shenjën ZL.Anr.1136/2017, të datës 18.12.2017, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit për Rivotim për Kryetar të Komunës së Istogut të mbajtura më datë 17.12.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën ZL.Anr.1136/2017 me datën 18.12.2017, nga Burim Kelmendi, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Istog, në të cilën pretendon se gjatë mbikëqyrjes së procesit të votimit nga vëzhguesit e subjektit politik AAK, si dhe vëzhguesit e organizatave tjera, është vërejtur se pjesëtarët e subjektit politik LDK, kanë organizuar votime me asistencë për 300 persona të moshave të ndryshme të cilët kanë ndikuar tek votuesit, për votim të detyrueshëm për subjektin politik LDK.

Si provë ka bashkangjitur një letër të printuar nga portali Express.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore edhe provave të bashkangjitura në ankesë gjeti se parashtruesi në ankesë me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar pretendimet e tij. Paneli vlerëson se shikimi i shkruar në portalin Express lidhur me të gjeturat në procesin e votimit në Komunë e Istogut gjatë ditës së votimit me dt.17.12.2017 nga Demokracia në Veprim (DNP) nuk paraqet provë në bazë të së cilës mund të konstatojmë se kemi të bëjmë me shkelje të cilat minojnë integritetin e zgjedhjeve. Po ashtu Demokracia në Veprim ndonëse ka qenë e certifikuar për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe e njëjta ka mundur të paraqes

në PZAP të gjeturat-shkeljet përmes ankesës, por një gjë të tillë nuk e ka bërë, andaj raportimet e publikuara në media nuk mund të merren si prova në bazë të cilave mund të vendoset se ka pasur parregullsi.

Për më tepër parashtuesi i ankesës nuk i ka plotësuar asnjë kusht ligjor që kërkohet me dispozitë ligjore të nenit 5 paragrafi 7 pika (c) e Rregullës Nr.02/2015 të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se : *“Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzimet se ku mund të gjenden dëshmitë, në rast kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit”*, sepse ankuesi vetëm ka theksuar se nga pjesëtarët e LDK-së, janë organizuar, për votim 300 persona duke mos e potencuar në asnjë rast ndonjë emër të personit konkret që e ka bërë organizimin apo nuk e ka specifikuar në asnjë Vendvotim apo Qendër e Votimit, ku janë bërë organizimet e atyre personave siç pretendohet në ankesë.

Prandaj, paneli ankesën e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së dhe nenit 5 paragrafi 7 pika (c) e Rregullës nr.02/2015 të PZAP-së. Rrjedhimisht PZAP-i, në mungesë të provave, dëshmime konkrete si dhe mungesës së udhëzimeve se ku mund të gjenden dëshmitë për parregullsitë e pretenduar në ankesë, e refuzoj ankesën si të pa bazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115, 117 dhe 118 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.1136/2017 më datën 19.12.2017

**Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi**



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*